



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

BURSA PËR STUDIME UNIVERSITARE DHE PASUNIVERSITARE NË SLOVAKI

VITI AKADEMIK 2017-2018 (II)

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Sllovakinë në fushën e arsimit, Qeveria e Republikës së Sllovakisë ofron bursa studimi universitare dhe pasuniversitare në nivelin bachelor/master dhe doktoraturë për shtetas shqiptarë, të cilët dëshirojnë të studiojnë në institucionet shtetërore të arsimit të lartë të Republikës së Sllovakisë për vitin akademik 2017-2018 sipas programeve të studimit në vijim:

1. Pedagogji, kujdestari, shkenca pedagogjike;
2. Ekonomi dhe menaxhim;
3. Ekologji dhe shkenca mjedisore;
4. Arkitekturë dhe inxhinieri;
5. Inxhinieri ndërtimi, teknologji, manifakturë dhe komunikim;
6. Agrikulturë;
7. Pylltari;
8. Menaxhimi i ujit.

Kandidatët e interesuar për këto bursa studimi duhet të dërgojnë **me postë** deri më datë **26.04.2017** në Drejtorinë e Integrimit dhe Projekteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, dokumentet e mëposhtme:

- *Për studime universitare **bachelor**:*

1. Kërkesën për studime universitare, duke specifikuar degën në të cilën kandidati dëshiron të studiojë. Kërkesa të jetë e nënshkruar nga kandidati dhe të përmbajë adresë e-mail dhe numër kontakti;
2. Vërtetimin e notave për dy vitet e para dhe të semestrit të parë të vitit të tretë të shkollës së mesme. Ky vërtetim duhet të jetë i firmosur nga Drejtoria Rajonale/Zyra Arsimore e rrethit përkatës dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
1. Fotokopjen e faqes se pasaportës me të dhënat e identitetit;
2. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
3. 4 (Katër) fotografi dokumenti

*Për studime pasuniversitare **Master**:*

1. Kërkesën për studime pasuniversitare, duke specifikuar degën në të cilën kandidati dëshiron të studiojë. Kërkesa të jetë e nënshkruar nga kandidati dhe të përmbajë adresë e-mail dhe numër kontakti;
2. Fotokopjen e noterizuar të diplomës së shkollës së lartë dhe listën e notave;
3. CV-në, në të cilën të pasqyrohen të dhëna për nivelet e studimit dhe të dhëna të tjera për punësimin nëse ka;

4. Dy letra rekomandimi;
5. Programin e studimit;
6. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
7. Fotokopjen e faqes se pasaportës me të dhënat e identitetit;
8. 4 fotografi dokumenti.

Për studime pasuniversitare në PhD:

1. Kërkesën për studime pasuniversitare ne PhD, duke specifikuar fushën e studimit
Kërkesa të jetë e nënshkruar nga kandidati dhe të përmbajë adresë e-mail dhe numër kontakti;
2. CV-në, në të cilën të pasqyrohen të dhëna për nivelet e studimit dhe të dhëna të tjera për punësimin nëse ka;
3. Kopjet e noterizuara dhe të legalizuara pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të diplomave ose të dokumenteve të ngjashëm që vërtetojnë mbarimin e programeve të studimit të nivelit të parë (bachelor) dhe të nivelit të dytë (master);
4. Kopjen e noterizuar dhe e legalizuar pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Supplementit të Diplomës Master si dhe të listës së plotë të leksioneve dhe provimeve me notat përkatëse;
5. Listën e botimeve të artikujve të ndryshëm;
6. Temën mbi të cilën mendohet të mbahet disertacioni (3-5 faqe);
7. Dy letra rekomandimi nga profesorë të institucioneve akademike;
8. Certifikata për kualifikime të ndryshme apo për veprimtari kërkimore;
9. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
10. Fotokopjen e faqes se pasaportës me të dhënat e identitetit;
11. 4 fotografi dokumenti.

Kushtet për përfitimin e bursës, përshkrimin e detajuar të degëve studimore, si dhe informacione të tjera gjenden në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Sllovakisë: www.minedu.sk (Scholarships of the Government of the Slovak Republic).

Kandidatët fitues do t'i nënshtrohen viti përgatitor të gjuhës sllovaqe, i cili fillon në shtator të vitit 2017. Informacion i detajuar për kursin e gjuhës sllovaqe gjendet ne faqen: www.cdvuk.sk.

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE